



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0560-A0001

Në çështjen juridike të:

Paditësi/ankuesi

I T, nga Kamenica- i përfaqësuar nga avokati B M, Prishtinë.

Kundër:

E paditura

N.SH. Jometalet "Kaolini", Kamenicë , përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-13-3910, të datës 30 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-13-3910, të datës 30 shtator 2022 dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI167-0009 i datës 22 nëntor 2013.**
- 3. Obligohet AKP– Autoriteti i Likuidimit të N.SH-së në likuidim, që në emër të dëmshpërblimit për ndërprerjeje të parakohshme të kontratës së punës, t'ia paguaj ankuesit shumën prej 900.00 €, sipas prioriteteve të përcaktuara me Ligj në procedurë të likuidimit.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedure ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 19 dhjetor 2013, pranë DJPGJSK-së është paraqitur ankesa nga paditësi kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për (AL), NSH Jometalet,, Kaolini” GJI 167-0009 të datës 22 nëntor 2013, me të cilin është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën 900.00 euro si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar konform nenit 608 të ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi në ankesën e tij ka theksuar se atij në bazë të Ligjit i takon kompensimi për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shumë prej 900.00 euro. Ka shtuar se me 05 korrik 2006 nga AKM-ja, zyra rajonale e Gjilanit ka marrë njoftimin zyrtarë që punësimi i ti përfundon dhe se në atë letër njoftim është shënuara se shumat-paga që janë mbetur borxh sipas kontratës së punës mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se këto do të shqyrtohen tek AL. Ankesës paditësi i ka bashkangjitur në kopje: vendimin e kundërshtuara të AL, listën përfundimtare të punëtorëve që kanë fituara 20% nga shitja e NSH-së, një njoftimit për shkëputjen e marrëdhënies së punës së NSH jometalet, “Kaolini “dt, 05 korrik 2006, si dhe njoftimin për futjen e N.SH-së në Likuidim.

Më 31 gusht 2018, e paditura ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje ndaj ankesës së paditësit me të cilën ka propozuar që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. E paditura ka theksuar se kërkesa është parashkruar konform nenit 608 të ligjit të Punës së Bashkuar. Tutje e paditura, pohon se NSH Jometalet “Kaolini” është privatizuar dhe të gjithë punëtorëve me këtë datë u është ndërprerë marrëdhënia e punës, prandaj punëtorët kërkesat për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës është dashur ti kërkojnë më së voni 3 vite nga data 29.06.2008, kur ka hyrë në fuqi Ligji i AKP-së 04/L-067. AKP-ja pohon se ai nuk ka asnjë dëshmi se paditësi i ka kërkuar këto paga para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent në afat prej 3 vitesh, andaj kërkesa është parashkruar.

Më 27 maj 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS, ka lëshuar Urdhër për paditësin dhe ka kërkuar që ankesa e ushtruar kundër Vendimit të AL të plotësohet, të dorëzoj Kontratën e punës, dëshminë në lidhe me lartasin e pagës, dëshminë se gjatë periudhës kontestuese ka punuara në NSH etj.

Urdhri i dt. 27 maj 2022, nuk kishte mundur ti dorëzohej paditësit, andaj Shkalla e I-rë e ka vendosur që të gjitha dorëzimet për paditësin të bëhen përmes publikimit në tabelë të shpalljeve të gjykatës, në kuptim të nenit 26.5 të Ligjit nr.06/L086, lidhur me nenin 116.5t ë LPK-së

Më 21 korrik 2022, Urdhri është publikuar në tabelën e shpalljeve.

Më 30 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së, kishte marrë Aktgjykimin C-IV.-13-3910, me të cilin ankesa e paditësit ishte refuzuar dhe është vërtetuar vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI 167-0009 dhe secila palë i heq shpenzimet e procedurës.

Në arsyetim të vendimit thuhet se nuk është kontestuese fakti se paditësi të ketë pasur të themeluar marrëdhënien e punës në NSH jometalet, "Kaolini", pasi i njëjti, sipas Listës përfundimtare të punëtorëve për të marrë pjesë në shpërndarje të 20%, paditësi gjendet në listë, por paditësi në ditën në ditën e ndërprerjes së kontratës së punës për shkak të shitjes së aseteve, më datë 05 korrik 2006, nuk ka dëshmuar se ai ka qenë në marrëdhënie të punës, ndërsa e paditura pretendon se kërkesa është parashkruar. Shkalla e I-rë e ka konstatuar se paditësi në ankesë kundër Vendimit të AL GJI167 -009, nuk ka bashkangjitur asnjë prove mbi bazën e së cilës e mbështet pretendimin në kërkesën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, se të njëjtit ju është ndërprere kontrata e punës për shkak të likuidimit, Shkalla e parë e DHPGJSK-së vlerësoi se ankesa është e pa bazuar. Më dispozitën e nenit 40. Të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034, dhe atë paragrafi 1.6.1 dhe 1.6.2, rregullohet:

„ 1.6.1.kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person:

1.6.2. kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Shkalla e I-rë ka vlerësuar se në rastin konkret, paditësi për të krijuar bazën juridike në lidhje me kërkesën e tij për dëmshpërblim për ndërprerje të

parakohshme të kontratës së punës është e nevojshme të vërtetohet faktin se deri te pushimi nga puna ka ardhur si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim, duke dorëzuar dëshminë si kontratën e punës dhe njoftimin për ndërprerje të kontratës së punës të lëshuar nga AKP-ja. Në arsyetim të vendimit thuhet se AKP-ja, ka lëshuar një njoftim për ndërprerje të kontratës së punës, më datë 05 korrik 2006, por ky njoftim nuk ju është drejtuar paditësit I T dhe nuk shihet dhe nuk dihet se ndaj cilit person është lëshuar, pasi emiri i personit është mbuluar me ngjyrë.

Më 12 dhjetor 2022, e paditësi/ankuesi ka parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJSK-së, kundër këtij aktgjykimit C-IV.-13-3910, për shkak të të gjitha arsyeve ankimore. Ankuesi i kundërshton të gjitha konstatimet e Shkallës së I-rë dhe i konsideron ato si konstatime të gabuara dhe të pa drejta. Paditësi ka propozuar Kolegjit të Apelit që ta aprovojë ankesën e tij si të bazuar, duke e aprovuar kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme kontratës së punës në shumën prej 900.00 euro nga NSH Jometalet "KAOLINI", si të bazuar.

Paditësi në ankesën e parashtruar konsideron se i janë cenuar të drejtat, pasi që ky aktgjykim, përmban shkelje të dispozitave material-juridike, ngase në bazë të shkresave të lëndës, respektivisht gjendjes faktike rezulton krejt ndryshe.

Paditësi konsideron se ky rast paraqet shkelje të parimit NE BIS IDEM pasi që e konsideron tek rasti C-IV.-13-3943 gjyqtari i DHPGJSK-së në pikën 3 citoj: Obligohet Autoriteti i Likudimit i AKP që ankuesit I T që në emër të kompensimit për 3 pagat e pa paguara, t'i paguhet shuma prej 900.00 euro. Ankuesi në ankesën e parashtruar nëpërmjet përfaqësuesit në Kolegjin e Apelit thekson se është No coment pasi që gjyqtari G S vendos më 22 nëntor 2021 që t'i kompensohen I T nga Kamenica tre pagat e pa paguara, kurse tani më 30.09.2022 gjyqtari S vendos që ankesa të refuzohet, duke e lënë në fuqi vendimin e AL GJI 167-0009. Ankuesi në ankesë thekson se në të gjithë rastet i ka respektuar afatet ligjore dhe nuk ka lejuar t'iu ikë ndonjë afat në asnjë mënyrë.

Paditësi ka theksuar se sa i përket marrëdhënies së punës janë dëshmitë ai ka bashkangjitur provat e mjaftueshëm në Shkallët të I-rë, vendimin e kundërshtuar të AL, listën e përfitimit të 20 % nga shitja NSH-së, Njoftimin e AKM-së për shkëputjen e marrëdhënies së punës dt. 05 korrik 2006, e që përputhet në plotësi me librezën e punës. Në shkresat e lëndës është vendimi i marrë pasi që Bordi i AKM-së ka ofruar shitje përmes tenderit ndërmarrjen shoqërore pikërisht më 05 korrik 2006 në ora 12.00, kur edhe i ka njoftuar punëtorët që ju ka përfunduar

marrëdhënia e punës si dhe listën përfundimtare të punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kriteret për marrje pjesë të hyrave, në të cilën është edhe emri i paditësit i katërti nga fundi,(për të cilën gjyqtari thotë se është me ngjyrë dhe e palexuar).

Paditësi thekson se ankesës i ka bashkangjitur edhe prova të tjera të cilat janë qartë të lexueshme. Ankuesi/ paditësi ka theksuar se NSH i ka mbyllë librezën e punës për shkak të likuidimit të NSH-së, e kështu që pas 17 viteve, 4 muaj dhe 12 ditë pune ka mbetur i pa punë.

Paditësi e kundërshton aktgjykimin e atakuar pasi që sipas tij më 27 maj 2022, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar Urdhëresë C-IV-13-3910, me të cilin ka kërkuar plotësimin me prova shtesë, por nuk ka treguar se cilat janë ato! Më 31 maj 2022 është bërë tentimi i dorëzimit në adresën në adresën e paditësit, por nga fletë dorëzimi është konstatuar se: "paditësi jeton me familje në Prishtinë" se gjëja nuk e ka njoftuar gjykatën për ndryshimin e vendbanimit.

Paditësi thekson se ka parashtruar parashtresë urgjente më datën 9 gusht 2021 të protokolluar më 10 gusht 2021, ku së bashku me Autorizimin e datës 06 gusht 2021 për angazhimin e përfaqësuesit si dhe ndërrimin e adresës së vendbanimit të ankuesit I T, Kamenicë, Rr."..", nr.11. Pra, jo si në adresën me të cilën ka tentuar gjykata si në padi e cila ka qenë Rr."...". Pra ky njoftim ishte bërë më 10 gusht 2021, kurse Aktgjykimi është i datës 30 shtator 2022. Tutje paditësi thekson se ankesës i ka bashkangjitur fakte dhe prova relevante dhe vendimtare që qojnë drejtë një vendimi meritor e ligjor duke marrë për bazë rrethanat e lartë përmendura. Paditësi ka bashkangjitur Aktgjykimin e Shkalles ss I-rë C-IV-13-3943, dt. 22 nëntor 2021, ku atij gjykata i ka njohur 3 paga e papaguara nga N.Sh jometalet "kaolini", në likuidim, një parashtresë dt. 12 tetor 2022, për paraqitjen e provave të reja, kërkesën e ushtruar tek AL për kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dt. 20 janar 2014, librezën e punë së N.Sh nr. serisë 116682, njoftimin për ndërprerja të marrëdhënies së punës ne NSH, listën e 20 % nga shitja e NSH-së.

Më 12 dhjetor 2023, Kolegji i Apelit këtë ankesë i'a ka dërguar të paditurës për përgjigje. Në përgjigjen e datës 21 dhjetor 2023, e paditura i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit/ankuesit dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në

ligj. E paditura në përgjigjen në ankesën thekson se aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJSK-së është i bazuar në ligj e prova dhe si i tillë ai duhet të konfirmohet (lihet në fuqi nga Kolegji i Ankesave). E paditura në mbrojtjen e saj lidhur me argumentet e ankesës thekson se është qartësisht dhe mjaftueshmërisht i sqaruar në mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktgjykimin me nr.C-IV.-14-3910 nga DHPGJSK-ja, pranë Shkallës së I-rë. Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parshtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtarë i parashtron kolegjit të Ankesave që t'i referohet Mbrojtjes dhe Aktgjyimit përkatës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të ndryshohet, dhe të aprovohet padia si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 21 tetor 2013, e ka dorëzuar një kërkesë për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, në shumë prej 900.00 nga NSH Jometalet "Kaolini", Kamenicë. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë, ka theksuar se ai me datë 05 korrik 2006, e ka pranuar njoftimin nga AKM-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si rezultat i privatizimit të NSH Jometalet "Kaolini", dhe në këtë njoftim ai ka pohuar se është theksuar se punëtorët do të

njoftohen lidhur me kërkesat për pagat e pa paguara pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuara dhe ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI167-0009, të datë 22 nëntor 2013.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, në shumë prej 900.00 euro nga NSH Jometalet "Kaolini", Kamenicë nuk është mbështetur në prova. Paditësi në shkallë të I-rë, ka paraqitur si prova vendimin e kundërshtuar të AL, listën përfundimtare të punëtorëve që kanë fituar 20% nga shitja e NSH-së, një njoftimit për shkëputjen e marrëdhënies së punës së NSH jometalet, "Kaolini "dt, 05 korrik 2006, si dhe njoftimin për futjen e N.SH-së në Likuidim. Po ashtu kolegji i Apelit vëren se paditësi me parashtresën e dt. 10 gusht 2021, e kishte njoftuar Gjykatën për ndërrimin e adresës dhe angazhimin e avokatit të tij. Kolegji gjithashtu vëren se paditësit Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV.-13-3943 të dt. 22 nëntor 2021, (të cilën paditësi e ka sjellë si dëshmi të Kolegji i Apelit) i kishte njohur kompensimin për 3 pagat e pa paguara, duke u mbështetur pikërisht në provat siç ishte Lista e për njohën e 20 % , njoftimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dt. 05 korrik 2006.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja në përgjigjen në ankesë nuk e ka kontestuar shprehimisht lartësinë e kërkuar për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, por e njëjta është thirrur në parashkrim të kërkesës.

Andaj duke u bazuar në provat të cilat paditësi i ka në dosje të lëndës siç janë: lista e punëtorëve për përfitimin e 20 % ku shihet edhe emri e paditësit, kërkesa e ushtruar tek AL për kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dt. 20 janar 2014, librezën e punë së N.Sh nr. serisë 116682, njoftimin për ndërprerja të marrëdhënies së punës në NSH. Jometalet "Kaolini" dt.05 korrik 2006, vërehet se paditësit ishte punëtor aktiv i NSH-së gjer me datën e privatizimit të NSH-së kur atij i ishte ndërprerë punësimi.

Kolegji i Apelit gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në përgjigje ndaj ankesës se kërkesa e ankuesit është e parashkruar. Thirrja në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, sipas gjykatës nuk është i argumentuar, pasi që me këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis).

Neni 40.1.6.2. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës të punëtorëve. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL, kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë paditësi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës, meqë parashkrimi i kërkesë është ndërprerë me njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës në NSH. Jometalet "Kaolini" dt.05 korrik 2006, prandaj thirrja e AKP-së në nenin 608 është e pa bazuar.

Kolegji i Apelit konstaton se baza ligjore për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së punësimit ekziston në nenin 40.1.6.2. të shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në, i cili parasheh që punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës nëse " *janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në* ". Privatizimi është një ndër veprimet e AKP-së të parapara me nenin 6.2.1 të Ligjit për AKP-në, prandaj kërkesa për dëmshpërblim e paditësit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës është vlefshme dhe e bazuar, pasi që AKM paditësit me anë të njoftimit të dt. 05 korrik 2006, i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës si rezultat i privatizimit të NSH-së.

Andaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e aprovoi ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshoi Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit, si dhe e aprovoi padinë si të bazuar.

Nga se u tha më sipër, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Nuk caktohen taksa gjyqësorë për paditësin/ ankuesin. Udhëzimi Administrativ Nr.01/2007 për unifikimin e taksave gjyqësore, në nenin 13.3, parasheh që punëtorët për pagat e papaguara lirohen nga pagimi i taksave gjyqësore për shumat e kërkesave deri në 1000 €. Lartësia e kërkesës së ankuesit ishte nën 1000 €, prandaj ankuesi lirohet nga taksa.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 14 mars 2024.

Mr.Sc, Sahit Sylejmani Gjyqtar kryesues _____